

SUBJEKTI "KASTRIOTI" SH.P.K.

2018

KRUJE me 01.08.2018

**DREJTUAR: AKM-TIRANE
PER DIJENI: DRM-DURRES
KRUJE**

**LENDË: KERKESE PER PJESEMARRJE NE ORGANIZIMIN E
KONSULTIMIT ME PUBLIKUN DHE PALET E INTERESUARA PER
APLIKIMIN PER LEJE MJEDISI TE TIPIT B: ID 3.7 NXJERRJA E
MINERALEVE, RËRËS DHE ARGJILËS NGA MINIERAT ME
SHFRYTËZIM NË QIELL TË HAPUR
(KARRIERE PER SHFRYTEZIMIN E GURIT GELQEROR)**

SUBJEKTI : "KASTRIOTI" SH.P.K.

ADMINISTRATORI: Z. VESEL KULLA

**ADRESA: DURRES KRUJE, NXJERRJE E GURIT GELQEROR NE
GUROREN PRANE MAKARESH, KRASTE, KRUJE.**

KRUJE 2018

Subjekti "KASTRIOTI" Sh.P.K. me perfaqesues ligjor Z.VESEL KULLA merret me Aktivitetin ID 3.7 Nxjerrja e Mineraleve, Rërës dhe Argjilës nga Minierat me shfrytëzim në qiell të hapur (Shfrytëzim Karriere guri gelqeror).

**SUBJEKTI : SUBJEKTI "KASTRIOTI" SH.P.K. ME NR. NIPTI J64102265P
ADMINISTRATORI: Z. VESEL KULLA**

Subjekti ka disa vite që ushtron aktivitetin në këto Karriere. Në afërsi të zonës ku zhvillon aktivitetin subjekti nuk ka shkollë, vepra arti, argjinatura, linje elektrike dhe linje uji që mund të demtohen nga zhvillimi i aktivitetit.

Perveç interesit ekonomik, investitori ka bërë rregullime, sisteme të sheshit për objektin dhe rrugëve.

Duhet theksuar që subjekti ka disa vite që e ushtron këto aktivitete në këto ambiente dhe nuk ka patur asnjehere probleme me komunitetin dhe sipërmarrësit që kanë aktivitetet pranë Aktivitetit.

Teritori i zgjedhur është mjaft i përshtatshëm për funksionimin e këtij aktiviteti duke paraqitur disa përparësi si:

- Sistem perspektiv të furnizimit me energji elektrike.
- Mundësi për zbatimin korrekt të projektit
- Mundësi për ngritje të sistemit të kanalizimeve dhe shkarkimeve.

Pozicioni i Karriere Guri gelqeror ka të zgjidhura disa nga problemet që lidhen me anën funksionale si.

- Largësi të mjaftueshme nga vendet e banuara.
- Pranë fuqisë punëtore.

Objekti ndodhet në distancë të largët nga qendrat e banuara, duhet theksuar se objekti është kullote i zhveshur, dhe nuk ka pamje nga rruga, si dhe aktiviteti ka bërë të mundur zbutjen e papunësisë në këto zone, duke bërë punësuar një pjesë të mirë të

banoreve te kesaj zone.

- Kapaciteti prodhues vjetor i Karrieres eshte 20.000 m³ / vit.
- Siperfaqja e Karrieres eshte 0.022 km².

Ne te operojne teknologjia dhe instalimet perkatese, ambientet e sherbimeve mbeshtetese dhe parkimi.

Nisur edhe nga qellimi i kesaj verpimtarie shqyrtimi i alternativave eshte i veshtire sepse flitet per objekte minerare me cilesi minerali unike te cilat plotesojne kriteret e kerkuara nga tregu perkates. Kuptohet qarte qe kemi te bejme me nje investim te madh nga investitori i cili se pari analizon koston dhe perfitimin

1. Objekti permban rezerva mineral te mjaftueshme te shfrytezueshme.
2. Kerkon investime te pranueshme per venien nen shfrytezim.
3. Paraqet mundesi aksesit rrugore ne objekt dhe faktoret klimatike te zones favrizojne veprimtarine
4. Ne zone egziston krahu i punes etj
5. Nuk cenon vlera cilesore apo te vecanta mjedisore dhe sociale
6. Eshte miratuar nga Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjitikes dhe institucionet lokale te shtetit dhe komuniteti i zones.

Procesi i prodhimit dhe karakteristikat e tij

Procesi i prodhimit pra shfrytezimit dhe terheqjes se mineralit behet ne qiell te hapur me Karriere.

Karriera shfrytezohet rreth 260 dite ne vit dhe paralel me hapjen e Karrieres jane bere edhe sistemimet perkatese te profileve te shfrytezuara.

Per te realizuar shfrytezimin ketu realizohet me ekstravator dhe eskavator me cekic pneumatic dhe transporti behet me kamione.

Pervec interesit ekonomik , investitori ka bere rregullime ,sistemime te sheshit para

objektit, rrugeve, ka krijuar hapsira te gjelberta.

Duhet theksuar qe subjekti ka disa vite qe e ushtron kete aktivitet ne keto ambiente dhe nuk ka patur asnjehere probleme me komunitetin dhe sipermarresit qe kane aktivitetet prane .

Teritori i zgjedhur eshte mjaft i pershtatshem per funksionimin e ketij aktiviteti duke paraqitur disa perparesi si:

- Sistem perspektiv te furnizimit me energji elektrike.
- Mundesi per zbatimin korekt te projektit
- Mundesi per ngritje te sistemit te kanalizimeve dhe shkarkimeve.

Pozicioni i Nyje perpunimin inertesh ka te zgjidhura disa nga problemet qe lidhen me anen funksionale si.

- Largesia te mjaftushme nga vendet e banuara.
- Prane fuqise punetore.

Objekti ndodhet ne distanca te largeta nga qendrat e banuara, si dhe aktiviteti ka bere te mundur zbutjen e papunesise ne kete zone, duke bere punesuar nje pjese te mire te banoreve te kesaj zone.

Operacionet kryesore gjate fazes se prodhimit jane:

- Rrezimi i masave me cekic pneumatic
- Punime sistemimi te perkohshemm
- Ngarkimi ne kamione dhe transporti

Per nga natyra e proceseve te prodhimit mund te thuhet se jane procese te natyres fiziko – mekanike dhe nuk do te kete procese te mirefillta kimike dhe perdorimi i agjenteve te vecante kimike ne procesin e prodhimit.

Teknologjite dhe makinerite e projektit

Ne procesin e zbulim – prodhimit punohet me keto makineri dhe teknologji:

- Ekskavatore
- Cekic pneumatic
- Kamione transporti

Energjia qe perdor teknologjia eshte e lendes djegese fosile dhe perkatesisht naftes diesel 10pm.

Aktiviteti zhvillohet ka kohë që ekziston dhe nuk ka patur asnje problem me komunitetin dhe nuk ka shkaktuar probleme të ndotjes së mjedisit.

Me këtë raport sigurojmë organet përkatëse shtetërore, vendim – marrëse, se projekti i zbatimit dhe teknologjia e projektuar është bashkëkohore, cilësore dhe plotëson standartet e vendosura nga Bashkimi Evropian.

Aktiviteti jone ka bere të mundur zbutjen e papunesise ne kete zone, duke bere punesuar nje pjese te mire te banoreve te kesaj zone.

Ne Karriere dhe Nyje fraksionimi Inertesh jane punesuar 8 punonjes te perhershem.

Nga pikpamja sociale, zhvillimi i ketij aktiviteti eshte faktor per zbutjen e papunesise dhe burim te ardhurash per familjet qe jetojne duke punuar ne kete shoqeri.

Në territorin përreth objektit infrastruktura inxhinjerie është në gjendje të mirë, rrugët janë të shtruara, sipërfaqet e lira janë të gjelbëruara me pemë dekorative, sistemi i kanalizimeve, rrjeti elektrik dhe ujësjellësi janë në gjendje të mirë.

Arsyet për përzgjedhjen e këtij vendi për të kryer aktivitetin Z. VESEL KULLA janë:

- Aktiviteti ndodhet në një vend startegjik për zhvillimin e aktivitetit.
- Aktiviteti ndodhet në një zonë qe nuk dëmton Komunitetin.

Ndikimet në mjedis

Ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi:

- Nuk ka prodhim të mbetjeve të rrezikshme

- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikoj në ndryshimin e nivelit të ujrave tokësore, në rrugët ujore dhe në nivelin hidrostatik të ujrave nëntokësore, pasi në këtë zonën ku ndodhet objekti dhe përreth tij nuk ka burime ujore nëntokësore dhe shpime të ndryshme hidrogjeologjike që do të mund të dëmtoheshin nga ky aktivitet.
- Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta.
- Gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë shkarkime të lëndëve ndotëse në ujë.
- Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në cilësinë e ajrit të zonës, pasi nuk do të ketë shkarkime në ajër të gazrave, pluhurave apo tymrave.
- Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë emetime të ndryshme kimike të llojeve të ndryshme.
- Nuk parashikohen dëmtime të florës dhe faunës së zonës.
- Zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës sanitare të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth. Niveli i zhurmes nuk i kalon 55-80 dB(A) gjatë punës. Ky nivel zhurmash është brenda normave dhe nuk ndikon në shëndetin e punonjësve.
- Ka vlera normale të temperaturës dhe të lagështisë në mjediset e punës
- Janë marrë të gjitha masat për mbrojtjen në punë nga aksidentet dhe për evitimin e rrezikut nga zjarri.
- Fenomene të tjera. Vibracioni, nxehtësia, radiacioni, ndriçimi verbues etj. nuk janë të pranishme.

Subjekti "KASTRIOTI" Sh.p.k. ka mjetet e nevojshme teknike dhe financiare për të zhvilluar këtë aktivitet dhe kërkon të jetë e pajisur me të gjitha lejet përkatëse sipas legjislacionit shqipëtar.

Konkluzione

Subjekti "KASTRIOTI" Sh.p.k. do ta ushtrojë veprimtarinë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe do të investojë për përmirësimin e mjedisit, punës dhe do të mirëpresë çdo sygjerim në të mirë të cilësisë së punës, si dhe aktiviteti ka bërë të mundur zbutjen e papunësisë në këtë zonë, duke punësuar një pjesë të mirë të banorëve të kësaj zone.

Aktiviteti jone nuk ka nevojë për procedurën e VNM paraprake ose të thelluar të Ligjit Nr 10 440 për Vlerësimin e Ndikimit Në Mjedis, datë 7.7. 2011, pra nuk i nevojitet procedura e VNM, pasi është i pajisur me Leje Mjedisore dhe ka VNM të cilat do të dorëzojë në QKB kur të aplikojë për Leje të Tipit B dhe në Përputhje me VKM nr. 419 datë 25.06.2014 Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt tjetri, të kushteve për lejet respective të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja, ky subjekt duhet të aplikojë për leje mjedisi të tipit B në AKM-Tiranë.

Adresa e AKM-se, ku publiku mund të dergojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë Elektronike:

Adresa: Rruga "Sami Frasheri" Nr.4, Tirane, - Tel/Fax 04 2 371 237 www.akm.gov.al

KONFORM TE TE GJITHA AKTEVE DHE PROCEDURAVE
LIGJORE NE FUQI I DREJTOHEM AKM-TIRANE PER NDJEKJEN E
PROCEDURES KONSULTIMIT ME PUBLIKUN DHE PALET E
INTERESUARA PER APLIKIMIN PER LEJE MJEDISI TE TIPIT B:

ID 3.7 NXJERRJA E MINERALEVE, RËRËS DHE ARGJILËS NGA
MINIERAT ME SHFRYTËZIM NË QIELL TË HAPUR
(KARRIERE PER SHFRYTEZIMIN E GURIT GELQEROR)

ADMINISTRATORI
VESEL KULLA

TEL: 0692198999

